



MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



UN WOMEN SHQIPËRI

2023

Ky publikim është përgatitur nga UN Women Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri - Zbatimi i *acquis* të BE-së për Barazinë Gjinore” (EU4GE), që zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian përmes Fondit të Përshejtimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autoreve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

Autoret: Agustela Nini-Pavli, Ani Plaku, Katherine Belen, Dolly Wittberger

Përkthimi: Language Solution

Redaktimi: Language Solution, Monika Kocaqi

Faqosje dhe grafika: Erald Lamja

© 2023 UN Women. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

PASQYRA E LËNDËS

Shkurtesa dhe akronime	4
Hyrje	6
1. Korrupsioni - çështjet gjinore kryesore në Shqipëri	9
2. Barazia gjinore dhe masat kundër korrupsionit në kontekstin e anëtarësimit në BE	16
3. Lidhja e iniciativave kundër korrupsionit me <i>acquis</i> e BE-së për barazinë gjinore	20
3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit e tjerë përkatës	23
3.2. Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas “Rregulloreve të NDICI-it”	27
3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC	27
4. Mjetet kryesore për integrimin gjinor	32
4.1. Analiza gjinore	32
4.2. Statistikat gjinore mbi korrupsionin në kontekstin shqiptar	33
4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor	34
4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në masat kundër korrupsionit	35
4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor	36
4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor	38
5. Rekomandime të rëndësishme në masat kundër korrupsionit	39

LISTA E KUTIVE DHE TABELAVE

Kutia 1: Përmbledhje e çështjeve kryesore të pabarazisë gjinore që lidhen me korrupsionin	15
Kutia 2: Shembuj të politikave dhe programeve të përgjigjshme gjinore në politikën dhe programimin kundër korrupsionit	19
Tabela 1: Treguesit gjinorë të lidhur me masat kundër korrupsionit bazuar në udhëzuesin e UNODC.....	25
Tabela 2: Kërkesat minimale për përmbushjen e kriterëve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave të barazisë gjinore të OECD-DAC	29
Tabela 3: Veprimet prioritare për integrimin e qëllimeve të barazisë gjinore në përpjekjet kundër korrupsionit	40

SHKURTESA DHE AKRONIME

BE	Bashkimi Evropian
BPfA	Platforma për Veprim e Pekinit
BPGJ	Buxhetim i Përgjigjshëm Gjinator
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
COVID-19	Sindroma e rëndë akute e rrugëve të frymëmarrjes e shkaktuar nga koronavirus 2 (SARS-CoV-2)
EIGE	Instituti Evropian për Barazinë Gjimore
EU4GE	BE për Barazinë Gjimore
GAP	Plani i Veprimit (i BE-së) për Barazinë Gjimore
GCB	Barometri Botëror i Korrupsionit
GENDERNET	Rrjeti për Barazinë Gjimore i Komitetit të Ndhmës për Zhvillim, i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD DAC)
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
GRETA	Grupi i Eksperteve/Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
KR-BE	Korniza e Rezultateve e BE-së
KR-IPJ	Korniza e Rezultateve e Instrumenteve të Politikës së Jashtme
LBGJ	Ligji për Barazinë Gjimore
LGBTI+	Persona lezbike, gej, biseksualë/e, transgjimore/e, transseksualë/e, interseks dhe cilëtdo persona të tjerë orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinator dhe/ose karakteristikat e seksit të të cilëve/ave janë të ndryshme nga heteroseksualët/et

NDICI	Instrumenti i Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-DAC	Komiteti i Ndhmës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPPGJ	Prokurim Publik i Përgjigjshëm Gjnor
SANECA	Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit të Shqipërisë për Kapitujt Ekonomikë të Acquis
SASS	Seksioni i Statistikave dhe Anketave
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjnore
STE	Seria e Traktateve Evropiane
TBE	Traktat i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati për Funkionimin e Bashkimit Evropian
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjnore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNODC-INEGI	Qendra e Ekselencës në Informacion Statistikor mbi Qeverinë, Krimin, Viktimizimin dhe Drejtësinë
UNSCR 1325	Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Gratë, Paqja dhe Siguria”
VNRR	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator

HYRJE

Ky udhëzues për integrimin gjinor është pjesë e një vargu materialesh burimore që i janë vënë në dispozicion qeverisë së Shqipërisë përmes ndihmës teknike të BE-së dhe UN Women, me qëllim përshpejtimin e procesit të integritimit në BE. Qëllimi i tij është të sigurojë që dokumentet e ardhshme të politikave, planifikimit dhe programimit të përafrohen ngushtë me kuadrin ligjor dhe të politikave të BE-së për barazinë gjinore ("*acquis* për barazinë gjinore"), çka do të sjellë përmirësimin e rezultateve të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në mbarë vendin. Ai u drejtohet partnerëve të zhvillimit dhe integritimit të përfshirë në nisma të politikave, programimit dhe planifikimit, në kontekstin e anëtarësimit në BE. Në këtë grup përfshihen së pari nëpunëset/nëpunësit që formulojnë politikën dhe hartojnë programet e IPA-s, ekspertet/ekspertët që ofrojnë ndihmë teknike, drejtueset/drejtuesit e projekteve pranë Delegacionit të BE-së, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit që mbështesin reformën e përafritimit me BE-në dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të angazhuara në proceset e llogaridhënies dhe konsultimit. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ofrojë informacion të përmbledhur mbi çështjet gjinore kryesore në një fushë të caktuar të politikave dhe të tregojë se si mund të realizohet integrimi gjinor në terma praktikë. Udhëzuesi është parashikuar si një material përgatitor për hedhjen e bazave në këtë drejtim. Ai mund të përdoret nga individët si dokument orientues në punën e tyre të përditshme dhe shërben si material trajnimi në përpjekjet për të krijuar kapacitete dhe aftësi për integrimin gjinor.

Barazia ndërmjet grave dhe burrave është një parim themelor i Bashkimit Evropian. E drejta e grave për trajtim të barabartë është, para së gjithash, një nga të drejtat themelore të njeriut. Legjislacioni i BE-së, e njeh diskriminimin si të papranueshëm politikisht, pa përfitim ekonomik dhe të dënueshëm me ligj. Për këtë arsye, shteteve u kërkohet që të përmbushin kërkesat e *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Siç përcaktohet në legjislacionin e BE-së, strategjia për promovimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit, është integrimi gjinor. Rrjedhimisht, integrimi gjinor është një parakusht për përafritimin e standardeve kombëtare me parimet e BE-së dhe një element i pandashëm i proceseve vijuese të reformës.

Aspektet gjinore janë të rëndësishme dhe duhet të merren në konsideratë në kuadër të hartimit dhe programimit të politikave kundër korrupsionit, sepse gratë dhe burrat ndikohen nga korrupsioni në mënyra të ndryshme dhe ato/ata përjetojnë lloje të ndryshme praktikash dhe sjelljesh korruptive.¹ Korrupsioni ndikon në mënyrë të

1 UNODC (2020). "*Gender Brief for UNODC Staff - Mainstreaming gender in Corruption Projects/programmes*". ("Dosja gjinore për stafin e UNODC – Integrimi gjinor në projektet dhe programet kundër korrupsionit"). Shih: https://www.unodc.org/documents/Gender/Thematic_Gender_Briefs_English/Corruption_brief_23_03_2020.pdf

konsiderueshme dhe negativisht në gëzimin e të drejtave të njeriut dhe prek shumë fusha, si aksesin në drejtësi, të drejtat ekonomike dhe sociale, diskriminimin në gëzimin e të drejtave themelore dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Prandaj, në mënyrë që gratë dhe burrat t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të njeriut dhe për të trajtuar mungesën e ekuilibrit gjinor në pushtet dhe burime, është e rëndësishme që në përpjekjet kundër korrupsionit të integrohet edhe perspektiva gjinore. Të drejtat sociale dhe ekonomike, të drejtat qytetare dhe fuqizimi i grave në shekullin e 21-të nuk mund të realizohen në një shoqëri ku praktikat korruptive janë të përhapura gjerësisht. Ky udhëzues për integrimin gjinor në masat kundër korrupsionit, është i organizuar në pesë pjesë të shkurtra dhe synon të mbështesë aktorët e interesuar që:

- të kuptojnë problemet e pabarazisë gjinore në përpjekjet kundër korrupsionit;
- të njihen me rekomandimet e politikave dhe direktivat përkatëse të BE-së;
- të identifikojnë treguesit përkatës për integrimin gjinor në politikat kundër korrupsionit;
- të njohin metodat dhe mjetet e standardizuara të BE-së për përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore;
- të angazhohen në veprimtari të mëtejshme konkrete, bazuar në një listë të përmbledhur rekomandimesh kryesore.

Barazia gjinore nuk ka të bëjë vetëm me “gratë”.

Përkundrazi, ajo ka të bëjë me realitetet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në të gjithë shoqërinë; dhe me pranimin që këto realitete dhe nevoja duhet të vlerësohen dhe – çka është e rëndësishme – të edukohen.

Për këtë është e nevojshme të sigurohet që të gjithë njerëzit të fuqizohen që të luajnë një rol të plotë dhe produktiv në familje, komunitet, shoqëri dhe ekonomi. Të jenë vetë zot të jetës së tyre, të bëjnë zgjedhjet që dëshirojnë dhe, për rrjedhojë, të kenë akses të drejtë dhe të barabartë në shërbime, mbështetje dhe në mundësi.

Prandaj, qeverisja e përgjigjshme gjinore ka të bëjë me sigurimin që, në të gjitha politikat, programet, aktivitetet, përparësitë dhe buxhetet e përgatitura prej saj, qeveria mban parasysh nevojat dhe shqetësimet e ndryshme të grave dhe burrave, si dhe trajton dhe redukton pabarazitë ndërmjet tyre.

A janë gratë më pak të korruptuara se burrat? Kërkimi mbi lidhjet ndërmjet gjinisë dhe korrupsionit filloi 20 vjet më parë, dhe studimet arritën në përfundimin se sa më shumë gra të ketë në pushtet aq më pak i korruptuar është vendi. Megjithatë, eksperimentet dhe studimet e mëvonshme tashmë kanë treguar se në 'rrethanat e duhura, gratë dhe burrat kanë të njëjtat prirje për të qenë të korruptuar'. Megjithatë, arsyeja përse qeveritë me më shumë gra në pushtet janë me të vërtetë më pak të korruptuara, është se këto qeveri zbatojnë edhe parime të tjera të qeverisjes demokratike, si shtypi i lirë, sundimi i ligjit dhe zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Sot, pranojmë se **aspektet gjinore ndikojnë dhe formësojnë kulturat në mbarë botën** dhe se ato bëhen pjesë në fusha të ndryshme të jetës sonë. Duke u mbështetur në këtë universalitet, korrupsioni ndikon te gratë dhe burrat në mënyrë të ndryshme në të gjithë botën. Në shumë shoqëri, gratë vijnë të jenë ofruese kryesore të kujdesit në familje dhe përballen rregullisht me korrupsionin gjatë ndërveprimit me shërbime si arsimit, shëndetësia dhe shërbime të tjera publike. Në sektorin e kujdesit shëndetësor, gratë janë veçanërisht të cenueshme, pasi ato kanë nevojë të shëndetit seksual e riprodhues që mund të kërkojnë rregullisht vëmendje. Ato mund të përballen me korrupsion për gjëra të thjeshta si caktimi i orareve të vizitës, e deri tek detyrimi për të paguar për një trajtim të cilin kanë të drejtë ta marrin falas. Për më tepër, rrjetet e patronazhit që priren të mbizotërohen nga burrat, i **përfshijnë gratë nga pjesëmarrja** ose aksesin në sektorët publik dhe privat, si dhe në sferën politike.

Bazuar në: *"The Time is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption"*, ("Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit"), UNODC, 2020.
Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

1 KORRUPSIONI - ÇËSHTJET GJINORE KRYESORE NË SHQIPËRI

Shqipëria ka bërë përpjekje për të krijuar një historik rezultatesh të shëndosha në luftën kundër korrupsionit dhe për ngritjen e një kuadri ligjor për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e integritetit të nëpunësve/nëpunësve publikë. Megjithatë, korrupsioni është i pranishëm në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe mbetet një problematikë shqetësuese, përfshirë edhe nga këndvështrimi gjinor. Ndalimi i korrupsionit kërkon vullnet politik dhe veprime më të strukturuar, të vazhdueshme dhe të përgjigjshme gjinore.

Korrupsioni lidhet me përfaqësimin e ulët të grave dhe me përjashtimin e tyre nga qendrat dhe rrjetet e pushtetit. Studimet sugjerojnë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis korrupsionit dhe përfaqësimit të ulët të grave në administratën publike dhe në biznes. Gratë shkurajohen nga përpjekjet për të bërë karrierë në politikë dhe biznes, ku korrupsioni është në nivele të larta.² Si tregues i një qeverisjeje jo të mirë, korrupsioni mund t'i zërë gratë në kurth në një rreth vicioz me pabarazi gjinore dhe mungesë fuqizimi: puna kërkimore në 18 vende evropiane tregon se korrupsioni, klientelizmi dhe rrjetëzimi politik kanë ndikim negativ në përqindjen e grave të zgjedhura në këshillat vendorë, duke pakësuar kështu më shumë mundësitë për përfaqësimin politik të grave.³ Kjo nuk vjen vetëm se gratë zgjedhin të mos futen në rrugëtimin e pushtetit, por edhe sepse gratë shkurajohen në mënyrë aktive nga diçka e tillë, duke qenë se ato konsiderohen gjerësisht si jashtë nga 'klubet e djemve' që janë vendosur me kohë në institucionet e pushtetit. Në veçanti, gratë nga grupet e disavantazuara (gratë rurale, gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, ato të komunitetit LGBTI+) mbeten gjerësisht të nënpërfaqësuar në jetën politike dhe publike, përfshirë në organet e zgjedhura, qeveri dhe administratë publike në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, policinë e shtetit apo forcat e armatosura. Ky ishte gjithashtu një nga vëzhgimet përfundimtare për Shqipërinë, të Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).⁴

Në Shqipëri mungojnë të dhënat për mënyrën se si korrupsioni ndikon në pjesëmarrjen politike dhe publike të grave dhe, disa sektorë, të cilët mund të

2 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*. (Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

3 Transparency International (2016). *Gender and Corruption. Topic Guide*. (Gjinia dhe korrupsioni. Udhëzues tematik). Shih: https://www.transparency.org/files/content/corruptionqas/Topic_guide_gender_corruption_Final_2016.pdf

4 UN CEDAW (2016). *Concluding observations on the 4th periodic report of Albania: Committee on the Elimination of Discrimination against Women*. (Vëzhgimet përfundimtare mbi raportin e 4-rt periodik të Shqipërisë: Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave). Shih: <https://digitallibrary.un.org/record/840818?ln=en>

jenë më të ekspozuar ndaj praktikave të korrupsionit, vijnë të mbizotërohen nga burrat. Për shembull, GRECO (organi i Këshillit të Evropës i ngarkuar me monitorimin e përputhshmërisë së shteteve me standardet e organizatës kundër korrupsionit) thekson në raportin e tij të fundit për Shqipërinë se punonjëset gra zënë rreth 13 për qind të stafit në Policinë e Shtetit, duke inkurajuar për rrjedhojë autoritetet shqiptare, të vijnë përpjekjet e tyre për ekuilibër gjinor në Policinë e Shtetit, sepse diversiteti është instrument kryesor për parandalimin e të menduarit në grup pa pranim alternativash, dhe nga ana tjetër, korrupsionit.⁵

Korrupsioni ndikon mbi gratë, veçanërisht lidhur me aksesin e tyre në drejtësi.

Kur shteti i së drejtës dhe sistemet e drejtësisë janë të korruptuara gratë bëhen më të cenueshme, çka është veçanërisht e dukshme kur bëhet fjalë për rrezikun e shtuar të dhunës me bazë gjinore dhe krimin. Për shembull, mungesa e besimit në sistemin gjyqësor dhe korrupsioni në polici e kanë vështirësuar parandalimin dhe përgjigjen ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, duke ndikuar kryesisht te gratë dhe fëmijët. Sipas raportit më të fundit të GRETA (Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore) trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri mund kryhet nga grupe të organizuara kriminale, të cilat përdorin korrupsionin për t'iu shmangur ligjit dhe pastrimin e parave për të fshehur fitimet e tyre. Raporti ngre gjithashtu pikëpyetje lidhur me informacionin e dhënë nga autoritetet shqiptare për zero raste të zbuluara të nëpunësve/nëpunësve publikë shqiptarë të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore. Ai u referohet palëve të ndryshme të kontaktuara gjatë vlerësimit të GRETA-s të cilët flasin për situata ku mund të ketë korrupsion, për shembull, raste kur një viktimë denoncon një shkelje në polici dhe më pas ky denoncim nuk regjistrohet për shkak të lidhjeve familjare ose lidhje të tjera midis oficerëve/oficerëve të policisë dhe trafikantëve.⁶

Gratë përballen me ekspozim më të madh ndaj korrupsionit kur kanë nevojë për shërbime shoqërore. Në shumë shoqëri, gratë vijnë të jenë ofruese kryesore të kujdesit në familje dhe, si pasojë, përballen rregullisht

5 Këshilli i Evropës, GRECO – Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (2020). *Fifth Evaluation Round, Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies. Evaluation Report Albania*. (Raundi i pestë i vlerësimit për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në qeverisjet qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit). Raport vlerësimi për Shqipërinë. Shih: <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680a0923d>

6 Këshilli i Evropës, GRETA - Grupi i Ekspertëve/Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2020). *Third evaluation round, Access to justice and effective remedies for victims of trafficking in human beings. Evaluation report Albania*. (Raundi i tretë i vlerësimit, Qasja në drejtësi dhe mjetet ligjore të efektshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Raport vlerësimi për Shqipërinë). Shih: <https://rm.coe.int/greta-2020-09-fgr-alb-en/1680a0b84f>

me korrupsion gjatë ndërveprimit me shërbime si arsimit, shëndetësia dhe shërbime të tjera publike. Një hulumtim paraprak në Shqipëri që u përqendrua në ndikimin gjinor të korrupsionit në sektorët e kujdesit shëndetësor dhe arsimit të lartë, nuk identifikoi pengesa institucionale kundër marrjes së ryshfetit gjatë ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor, ku pagesat jozyrtare me para në dorë të cilat kërkohen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga mjeket/mjekët janë jashtëzakonisht të përhapura. Sistemi shqiptar i kujdesit shëndetësor vuan nga një mungesë serioze e kapaciteteve dhe krijon mjedis të përshtatshëm për të kërkuar pagesa jozyrtare në këmbim të shërbimit, që plotësohen nga gatishmëria e qytetareve/qytetarëve për të përdorur mënyra të padrejta për të marrë shërbimin për të cilin kanë nevojë.⁷

Vlerësimi i ndikimeve specifike gjinore të korrupsionit në arsimin e lartë bazohet në provat e shumta ndërkombëtare që tregojnë se korrupsioni në këtë sektor ka ndërlkime alarmante për gratë, sepse pengon mundësitë e grave dhe vajzave në të ardhmen. Intervistat me studente/studentë dhe pedagoge/pedagogë universiteti në Shqipëri tregojnë se nepotizmi lidhur me pranimin e studenteve/studentëve dhe emërimin e stafit ka ndërlkime gjinore, që pakësojnë mundësitë e grave për akses në burime apo pozicione me ndikim. Përcaktimi i shkallës së ndikimit të këtyre praktikave mbi karrierën dhe mundësitë në jetë, për gratë pjesë e stafeve të universiteteve në Shqipëri, kërkon hulumtim të mëtejshëm.⁸

Format gjinore të veçanta të korrupsionit prekin gratë në mënyrë jo proporcionale. Disa forma gjinore të veçanta të korrupsionit përjetohen në mënyrë jo proporcionale nga gratë, si shfrytëzimi seksual i trupit të gruas në këmbim të pagesës, ose zhatja seksuale. Kjo e fundit njihet në anglisht edhe si “sextorsion” dhe është një nga format më domethënëse të korrupsionit gjinor. Në këtë lloj korrupsioni, seksi kthehet në valutën e ryshfetit dhe individët detyrohen të angazhohen në akte seksuale në këmbim të shërbimeve themelore, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe arsimin.⁹ Ai mund të ndodhë në një sërë kontekstesh të ndryshme (p.sh., ndërmjet pedagogeve / pedagogëve

7 OSCE (2021). *The gendered impact of corruption in the Albanian health care and tertiary education sectors, Preliminary research and needs assessment*. (Ndikimi gjinor i korrupsionit në kujdesin shëndetësor shqiptar dhe në arsimin e lartë, Hulumtim paraprak dhe vlerësim nevojash). Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/513448.pdf>

8 *Po aty*.

9 Transparency International (2022). *Global Corruption Barometer. European Union 2021 - Citizen Views and Experiences of Corruption*. (Barometri botëror i korrupsionit. Bashkimi Evropian 2021 - Pikëpamjet dhe përvojat e qytetareve/qytetarëve për korrupsionin). Shih: https://www.transparency.si/wp-content/uploads/2021/06/gcb_eu_2021-web.pdf

dhe studenteve / studentëve, eprore / eprorëve dhe punonjëseve / punonjësve, nëpunëseve / nëpunësve publikë dhe emigranteve / emigrantëve).¹⁰ Vlerësohet se zhvatja seksuale është përhapur vitet e fundit dhe ka rezultuar në rritjen e rrezikut që gratë dhe vajzave të detyrohen të kryejnë favore seksuale në shkëmbim të shërbimeve. Problemi përkeqësohet më tej nga kultura e turpfit dhe fajësimit të viktimës, që e ul nivelin e denoncimit të shfrytëzimit seksual, si dhe ul gjasat që të njihet si korrupsion.¹¹ Vlerësimi paraprak i ndërmarre nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shqipëri tregon se zhvatja seksuale (praktika në të cilën seksi përdoret si valutë korrupsioni me efekte të rënda negative mbi gratë dhe vajzat) është e pranishme në sektorin e arsimit të lartë, megjithëse mbeten ende për t'u mbledhur dhe analizuar të dhëna më gjithëpërfshirëse për këtë çështje.¹²

Ka shumë dallime gjinore në perceptime, qëndrime dhe sjellje që lidhen me korrupsionin. Një sërë studimesh tregojnë se burrat kanë prirje ta shohin korrupsionin në një këndvështrim më pozitiv se sa gratë, sepse ata e konsiderojnë si mundësi për plotësimin e të ardhurave dhe mbase edhe për t'u pasuruar. Nga ana tjetër, gratë kanë më shumë gjasa se burrat që të besojnë se jetët e tyre janë të ndikuara negativisht nga korrupsioni.¹³ Sa i përket qëndrimeve dhe sjelljeve ndaj korrupsionit, gratë priren të dënojnë sjelljet e korrupsionit më shumë se burrat, megjithatë ato e denoncojnë korrupsionin më rrallë se burrat. Arsyeja e nënkuptuar është se kur gratë vendosin të denoncojnë ose të mos denoncojnë korrupsionin, ato janë më të shqetësuara se burrat për pasojat dhe mungesën e mbrojtjes.¹⁴ Faktikisht, ka të dhëna se

10 Zhvatja seksuale nuk ndikon vetëm gratë, dhe mund të përdoret edhe kundër burrave, si dhe njerëzve që nuk identifikohen me një gjini, ose transgjjinorëve. Megjithatë, disa grupe janë veçanërisht të cenueshme nga zhvatja seksuale për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, statusit ligjor, aftësisë së kufizuar, apo normave kulturore. Burimi: Shoqata Ndërkombëtare e Gjiqtareve Gra (IAWJ) (2012). *2012 Report: Naming, Ending and Shaming Sextortion* (Raport i vitit 2012: Emërtimi, dhënia fund dhe turpërimi i zhvatjes seksuale). Shih: https://www.unodc.org/ji/resdb/data/2012/_80_/naming_shaming_and_ending_sexortion.html

11 Transparency International (2016). *Gender And Corruption. Topic Guide*. (Gjinia dhe korrupsioni. Udhëzues tematik). Shih: https://www.transparency.org/files/content/corruptionqas/Topic_guide_gender_corruption_Final_2016.pdf

12 OSCE (2021). *The gendered impact of corruption in the Albanian health care and tertiary education sectors, Preliminary research and needs assessment*. (Ndikimi gjinor i korrupsionit në kujdesin shëndetësor shqiptar dhe në arsimin e lartë, Hulumtim paraprak dhe vlerësim nevojash). Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/513448.pdf>

13 Transparency International (2016). *Gender And Corruption. Topic Guide*. (Gjinia dhe korrupsioni. Udhëzues tematik). Shih: https://www.transparency.org/files/content/corruptionqas/Topic_guide_gender_corruption_Final_2016.pdf

14 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*. (Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

ankesat e grave lidhur me korrupsionin hetohen më rrallë.¹⁵ Të dhënat mbi këtë çështje në Shqipëri janë të pakta, por sipas një anketimi të kryer në 27 vende të BE-së, vetëm 44 për qind e grave mendojnë se mund të denoncojnë korrupsionin pa u frikësuar nga hakmarrja. Kjo frikë është e përbashkët për të gjitha gratë, pavarësisht moshës, arsimit, nivelit të informacionit, apo jetesës në zona urbane apo rurale.¹⁶

Korrupsioni ndikon negativisht barazinë gjinore dhe veprimin e grave.

Shumë forma të korrupsionit ndikojnë si gratë, ashtu edhe burrat. Megjithatë, ndërkohë që më shumë burra se gra përfshihen në korrupsion madhor dhe përvetësim fondesh, gratë në përgjithësi janë më të ekspozuara ndaj korrupsionit dhe pasojave negative të tij në jetën e përditshme. Kjo vjen si pasojë e marrëdhënieve të pabarabarta gjinore në shoqëri dhe nga fakti se gratë kanë më pak burime, si dhe qasje të kufizuar në drejtësi, krahasuar me burrat. Gjithashtu, gratë kanë më pak qasje në pozicione pushteti dhe influence, për shkak të pozicionit të tyre më të ulët shoqëror, politik dhe ekonomik dhe, korrupsioni e përkeqëson më tej këtë pabarazi.¹⁷ Për shembull, qasja e grave në shërbime mund të mohohet më shpesh për shkak të pamundësisë së tyre për dhënie ryshfeti.¹⁸ Gjithashtu, korrupsioni mund të rrisë varësinë e grave nga të tjerët, sepse ato duhet të gjejnë paratë për dhënien e ryshfetit, përfshirë përmes marrjes borxh nga të tjerët, çka rezulton në një rreth vicioz varfërie, borxhi dhe varësie ekonomike.

Korrupsioni ndikon edhe në aksesin e grave në vendimmarrje dhe fuqizimin e tyre në fusha të tjera, si në rastet kur kërkojnë punësim ose kur përpiqen të krijojnë bizneset e tyre. Korrupsioni në kontekstin formal dhe informal krijon pengesa lidhur me potencialin e të ardhurave të grave apo mundësitë për

15 Inter-American Development Bank (2018). *Gender Mainstreaming in the Transparency Fund. Guide prepared for the Transparency Fund by K. Sample.* (Integrimi gjinor në Fondin e Transparencës. Udhëzues i përgatitur për Fondin e Transparencës nga K.Sample). Shih: <https://publications.iadb.org/publications/english/document/Gender-Mainstreaming-in-the-Transparency-Fund.pdf>

16 Transparency International (2021). *Global Corruption Barometer (GCB)– EU.* (Barometri Botëror i Korrupsionit (GCB) – BE). Shih: <https://www.transparency.org/en/blog/women-eu-face-greater-barriers-speaking-up-corruption>

17 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption.* (Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

18 Transparency International (2016). *Gender And Corruption. Topic Guide.* (Gjinia dhe korrupsioni. Udhëzues tematik). Shih: https://www.transparency.org/files/content/corruptionqas/Topic_guide_gender_corruption_Final_2016.pdf

qëndrueshmërinë e bizneseve.¹⁹ Për më tepër, gratë kanë më shumë gjasa të jenë në presion të vazhdueshëm për të pranuar korrupsionin, sepse gratë përbëjnë një pjesë të madhe të sektorin informal ku korrupsioni priret të jetë edhe më i përhapur.

Mungesa e të dhënave gjinore mbi korrupsionin pengon trajtimin e sfidave gjinore të veçanta në këtë fushë. Të dhënat e ndara sipas seksit dhe statistikat gjinore janë thelbësore për të kuptuar mënyrat e ndryshme se si korrupsioni ndikon te gratë dhe burrat. Ato janë gjithashtu tepër të rëndësishme për ndërmarrjen e analizave gjinore, hartimin e politikave të përgjigjshme gjinore dhe krijimin e masave që mbrojnë efektivisht gratë dhe burrat nga korrupsioni. Në Shqipëri, të dhënat e publikuara mbi këtë çështje janë të mangëta. Në vitin 2010, INSTAT prodhoi të dhëna të ndara sipas seksit në kuadër të një anketimi mbi përvojën faktike të korrupsionit administrativ në Shqipëri.²⁰ Në vitin 2020, INSTAT kreu një testim për përllogaritjen e treguesit të OZHQ 16.5.1 ("Përqindja e personave që kanë pasur të paktën një kontakt me një nëpunës/nëpunës publik dhe i kanë paguar ryshfet asaj/atij, ose të cilëve u është kërkuar ryshfet nga ato/ata nëpunës/nëpunës publikë, gjatë 12 muajve të mëparshëm"). Në parim, metodologjia e përdorur nga INSTAT lejon ndarjen e të dhënave sipas seksit për këtë tregues. Konsolidimi i përgjithshëm i metodologjisë për përllogaritjen e treguesit të OZHQ 16.5.1 është aktualisht në punë e sipër. Po ashtu, metodologjia për përllogaritjen e treguesit të OZHQ 16.6.2 ("Përqindja e popullsisë e kënaqur me përvojën e tyre të fundit në shërbimet publike") lejon publikimin e të dhënave të ndara sipas seksit, por kjo nuk është testuar ende në Shqipëri.

19 Sida (2015). *Gender and Corruption – Gender Toolbox Brief*. (Gjinia dhe korrupsioni – Dosje e grupit të mjeteve gjinore). Shih: <https://www.sida.se/en/publications/gender-and-corruption>

20 UNODC (2011). *Corruption in Albania: Bribery as experienced by the population Report prepared by UNODC Statistics and Surveys Section (SASS) and Institute of Statistics of Albania (INSTAT)*. [Korrupsioni në Shqipëri: Raport mbi përvojën e popullsisë mbi ryshfetin, i përgatitur nga Seksioni i Statistikave dhe Anketave (SSA) i UNODC dhe Instituti i Statistikave i Shqipërisë (INSTAT)]. Shih: http://www.instat.gov.al/media/3587/corruption_in_albania.pdf

KUTIA 1

Përmbledhje e çështjeve kryesore të pabarazisë gjinore që lidhen me korrupsionin

1. Korrupsioni dhe përfaqësimi i ulët i grave në pozicione me pushtet, p.sh. në qeveri, biznes dhe politikë, janë të ndërlidhura.
2. Korrupsioni ndikon mbi gratë, veçanërisht lidhur me aksesin e tyre në drejtësi.
3. Gratë përballen me ekspozim më të madh ndaj korrupsionit kur kanë nevojë për shërbime shoqërore, përfshirë dhe shëndetësinë e arsimin.
4. Format gjinore të veçanta të korrupsionit ndikojnë gratë dhe vajzat në mënyrë jo proporcionale.
5. Gratë priren ta perceptojnë korrupsionin ndryshe nga burrat dhe të sillen ndryshe lidhur me të.
6. Korrupsioni ndikon negativisht barazinë gjinore dhe veprimin e grave.
7. Mungesa e të dhënave gjinore mbi korrupsionin pengon trajtimin e sfidave gjinore të veçanta në këtë fushë.

2 BARAZIA GJINORE DHE MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT NË KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Në BE, lufta kundër krimit është kryesisht përgjegjësi e autoriteteve të vendeve anëtare të BE-së, të cilat kanë përgjegjësinë kryesore për aspektet më të rëndësishme që lidhen me luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, sipas Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), Bashkimi Evropian mund të përcaktojë rregulla minimale që përkufizojnë shkeljet penale dhe sanksionet, veçanërisht në fusha të krimeve serioze me dimension ndërkufitar, si pastrimi i parave, korrupsioni dhe krimi i organizuar. Shembuj të nismave ligjore të miratuara vitet e fundit për luftën kundër korrupsionit në shkallë të BE-së përfshijnë direktivën për ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave të krimit, direktivën e 5-të kundër pastrimit të parave, direktivat e prokurimit publik dhe direktivën për përdorimin e informacionit financiar për të luftuar disa shkelje penale.

Këshilli i Evropës e konsideron korrupsionin një kërcënim serioz ndaj vlerave themelore të demokracisë pluraliste, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës në Evropë.²¹ Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë instrumentesh ligjore shumëdimensionale për trajtimin e korrupsionit:

- Konventa e së Drejtës Penale mbi Korrupsionin (ETS 173);²²
- Konventa e së Drejtës Civile mbi Korrupsionin (ETS 174);²³
- Protokollin shtesë i Konventës së të Drejtës Penale mbi Korrupsionin (ETS 191);²⁴
- Njëzet parimet udhëzuese kundër korrupsionit (Rezoluta (97)24);²⁵
- Rekomandimi për kodet e sjelljes së nëpunësve/nëpunësve publikë (Rekomandimi Nr. R(2000)10);²⁶
- Rekomandimi për rregullat e përbashkëta kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore (Rekomandimi Rec(2003)4);²⁷

21 Këshilli i Evropës, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) (Në internet). *The Fight against Corruption: A Priority for the Council of Europe*. (Lufta kundër korrupsionit: Përparësi e Këshillit të Evropës). Shih: <https://www.coe.int/en/web/greco/about-greco/priority-for-the-coe>

22 Shih: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=173>

23 Shih: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=174>

24 Shih: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=191>

25 Shih: <https://rm.coe.int/16806cc17c>

26 Shih: <https://rm.coe.int/16806cc1ec>

27 Shih: <https://rm.coe.int/16806cc1f1>

Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), ku Shqipëria është anëtare, është mekanizmi vlerësues themelor i Evropës kundër korrupsionit. Ai ka një qasje shumë-disiplinore për luftën kundër korrupsionit përmes instrumenteve ligjore të krijuara për të “forcuar kapacitetet demokratike, juridike dhe institucionale të vendeve anëtare për të përballuar korrupsionin, si dhe për ta identifikuar dhe ndëshkuar në mënyrë të efektshme kur ai ndodh”, si dhe për nxitjen e masave parandaluese të efektshme kundër korrupsionit në vendet e veta anëtare. GRECO është i përkushtuar të promovojë barazinë gjinore. Ai pranon se lidhja ndërmjet gjinisë dhe korrupsionit ka tërhequr më pak vëmendje në Evropë dhe në demokracitë më të zhvilluara, si dhe pohon se shqyrtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit është kritik për të identifikuar (i) se si strategjitë kundër korrupsionit mund të përfshijnë perspektivën gjinore dhe (ii) se si të promovohet më mirë barazia ndërmjet grave dhe burrave në kuadër të përpjekjeve kundër korrupsionit.²⁸

Përfitimet e trajtimit të qëllimeve të barazisë gjinore në politikën dhe programimin kundër korrupsionit përfshijnë²⁹:

- Korrupsioni përkeqëson disavantazhin e grave në shoqëri dhe programet kundër korrupsionit mund të kontribuojnë në mbështetjen e aftësisë vepruese të grave dhe fuqizimin e tyre politik, ekonomik dhe shoqëror.
- Korrupsioni dobëson përpjekjet për të thyer ciklin e varfërisë duke krijuar pabarazi në mënyrën se si të ardhurat, burimet dhe shërbimet ndahen midis grave dhe burrave dhe vajzave dhe djemve; dhe si pasojë trajtimi i korrupsionit është nevojë kritike në kuadër të hartimit të politikave/strategjive në mbështetje të të varfërve/varfërve.
- Ka një lidhje të ndërsjellë midis përfaqësimit më të ekuilibruar gjinor në këshillat vendorë dhe praktikave më të pakta të marrëveshjeve të fshehta në prokurimin publik.
- Trajtimi dhe lufta kundër korrupsionit në shërbimet publike mund të përforcojë qasjen e barabartë në shërbime të kujdesit shëndetësor, arsimit dhe drejtësisë dhe, kjo është veçanërisht e rëndësishme kur

28 Këshilli i Evropës, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), dhe H. Lisuchova (2012). *Gender dimensions of corruption*. (Dimensionet gjinore të korrupsionit). Shih: <https://rm.coe.int/16806cd01e>

29 Bazuar në: Transparency International (2014). “*Gender Inequality and Corruption: What are the Linkages?*” (“Pabarazia Gjinore dhe Korrupsioni: Cilat janë lidhjet mes tyre?”). *Dok. Politikash*. #01/2014, fq. 9, 2014; UNODC (2020). “*The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*”. (“Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit”).

merret në konsideratë fakti i provuar tashmë që qasja në shërbime përkeqësohet gjatë krizave (si pandemia e COVID-19, krizat ekonomike, etj.).

- Vënia në zbatim e politikave dhe programeve të fuqishme për trajtimin e korrupsionit, mund të përforcojë parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës me bazë gjinore, veçanërisht zhvatjes seksuale dhe trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual të grave dhe vajzave.

KUTIA 2

Shembuj të politikave dhe programeve të përgjigjshme gjinore në politikën dhe programimin kundër korrupsionit

Prokurimet publike në Shqipëri

Sipërmarrëset gra përbëjnë rreth vetëm një për qind të tregut në mbarë botën dhe shpesh bizneset e grave përballen me pengesa lidhur me qasjen në tenderat e prokurimit dhe për marrjen e kontratave. Nëse proceset e prokurimit janë më përfshirëse për gratë, ato jo vetëm që sjellin rezultate pozitive për sipërmarrëset gra, por shpesh rezultojnë në kontrata të zbatuara më mirë dhe kursime më të mëdha për qeverinë. Për më tepër, prokurimet me inteligjencë gjinore mund të ndihmojnë në uljen e korrupsionit duke e bërë procesin më llogaridhënës, transparent dhe me pjesëmarrje. Në vitin 2018, Instituti Shqiptar i Shkencës kreu një studim për proceset e prokurimit në vend. Analiza e të dhënave të mbledhura prej institutit krijoi mundësinë e studimit të efikasitetit të politikave që synonin të mbështesnin gratë sipërmarrëse në sistemin e prokurimit dhe siguroi prova për përfitimet e rritjes së mbështetjes për gratë në tregun e prokurimeve.

Burimi: OSBE (2021). *Gender and Corruption: What do we do now?* (Gjinia dhe korrupsioni: Çfarë do të bëjmë tani?) Një punim për diskutim. Shih: <https://www.osce.org/secretariat/507569>

Përfshirja e këndvështrimit gjinor në sistemin e drejtësisë për trajtimin e korrupsionit - Meksikë

Në vitin 2012, Gjykata e Lartë Kombëtare e Meksikës ndërmori një vlerësim me titull “Njohuritë dhe perceptimet e personelit të Gjykatës së Lartë të Meksikës lidhur me gjininë dhe të drejtat e njeriut”, si dhe një vlerësim për gjininë dhe kulturën e punës në 15 gjykata të larta të shteteve të vendit. Vlerësimet treguan se rreth 20 për qind e personelit gjyqësor nuk e dinin kuptimin e “këndvështrimit/perspektivës gjinore”, si dhe se koncepti i “drejtësisë gjinore” nuk kuptohej mirë. Madje u arrit në përfundimin se “qasja aktuale e Gjykatës së Lartë mbështetet ende në ide shumë të shtrembra mbi integrimin gjinor në spektrin e të drejtave të njeriut”. Për të trajtuar këto probleme, u miratua një Protokoll për Barazinë Gjinore për të udhëzuar gjyqtaret/gjyqtarët si të përfshijnë këndvështrimin gjinor gjatë dhënies së drejtësisë, për të siguruar që e drejta e barazisë përpara ligjit të jetë realitet, ashtu siç është e mishëruar në Kushtetutën e Meksikës dhe në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut.

Në vitin 2019, Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën e Lartë nisi të përditësonte Protokollin për Barazinë Gjinore duke ndërmarrë një proces konsultimi për të mbledhur vëzhgimet, shqetësimet dhe rekomandimet e përfaqësueseve/përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë, akademikeve/akademikëve dhe organizatave të shoqërisë civile. Ushtrimi u ndërmor në bashkëpunim me Njësinë e Përgjithshme për Barazinë Gjinore të Gjykatës së Lartë të Drejtësisë së Kombit dhe me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile.

Burimi: UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*. (“Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit”) Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

3 LIDHJA E INICIATIVAVE KUNDËR KORRUPSIONIT ME ACQUIS E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE

Integrimi gjinor është një strategji që synon përfshirjen e **një këndvështrimi gjinor** në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, strategjive, buxheteve, programeve të shpenzimeve, aktiviteteve të projekteve, masave rregullatore, funksioneve administrative dhe kulturës institucionale, me synim promovimin e **barazisë ndërmjet grave dhe burrave**, si dhe parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit.

Integrimi gjinor siguron që hartimi i politikave dhe puna legjislative të jenë të një cilësie më të lartë dhe që politikatat t'u përgjigjen më me efektivitet nevojave të të gjitha/gjithë qytetareve/qytetarëve - gra dhe burra, vajza dhe djem. Me integrimin gjinor, ndërhyrjet publike bëhen më efektive dhe sigurojnë që pabarazitë të mos përsëriten në të ardhmen.

Objektivi kryesor i programeve të BE-së në vendet e (para)anëtarësimit është që shtetet candidate të mbështeten në punën për miratimin dhe zbatimin e të gjitha reformave (politike, institucionale, ligjore, administrative, shoqërore dhe ekonomike), të cilat kërkohet të jenë në përputhje me vlerat dhe të përafuara me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së. Kriteret e anëtarësimit (kriteret e Kopenhagës) përmbajnë parakushte të qarta për ekzistencën e institucioneve demokratike që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave.³⁰ Barazia gjinore, si një prej parimeve kryesore të shtetit ligjor, është pjesë përbërëse e pandarë e Strategjisë së Zgjerimit të BE-së.³¹ Zgjerimi kërkon nga secili vend kandidat për anëtarësim që të miratojë të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta (*acquis* e BE-së), të cilat janë të detyrueshme për të gjitha vendet anëtare të BE-së.³² Barazia gjinore është pjesë përbërëse e proceseve të anëtarësimit dhe të harmonizimit të legjislacionit, përmes zbatimit të këtyre parimeve që burojnë nga qasja e bazuar në të drejtat e njeriut: (i) ligjshmëria, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut; (ii) pjesëmarrja; (iii) mosdiskriminimi; (iv) llogaridhënia dhe përgjegjshmëria; dhe (v) transparenca në çdo hap të programimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të mbështetjes së BE-së.

30 Përfundimet e Presidencës së Këshillit Evropian, Kopenhagë, 21-22 qershor 1993. Shih: <https://www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf>

31 Komunikatë e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve. *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, 2018* (Një perspektivë e besueshme për zgjerimin dhe rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor, 2018), fq.4. Gjetet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52018DC0065>

32 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/acquis.html>

Në **nivelin e BE-së**, detyrimi për t'u angazhuar për integrimin gjinor buron, ndër të tjera, nga:

- Traktati i Bashkimit Evropian (TBE);³³
- Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE)³⁴ nenet 8 dhe 10, ku përcaktohen detyrimet e BE-së dhe të shteteve anëtare për të siguruar përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të gjitha veprimtaritë e BE-së;
- Direktiva 2004/113/EC e Këshillit e datës 13 dhjetor 2004³⁵, “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve”;
- Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 korrik 2006³⁶ “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim” (Direktiva e rishikuar).

Gjithashtu, integrimi gjinor është i pasqyruar qartësisht në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-2025)³⁷, dhe është pjesë përbërëse e Rregulloreve të Instrumentit të Asistencës së Para - Anëtarësimit të BE-së (IPA III)³⁸: **për t'u anëtarësuar në BE, vendeve candidate u kërkohet që të përmbushin detyrimet e përcaktuara në *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.**

33 Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012M%2FTXT>

34 Version i konsoliduar i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>

35 Direktivë e Këshillit Nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004, “*Implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services*” (Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0113>

36 Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 korrik 2006 “*On the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation*” (Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim) (Direktiva e rishikuar). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32006L0054>

37 Komunikatë e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe Këshillit: “*EU Gender Action Plan (GAP) III – An ambitious agenda for gender equality and women’s empowerment in EU external action*”. (“Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimin e jashtëm të BE-së”). Shih: https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf

38 Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale; ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

Në **nivel ndërkombëtar**, Shqipëria ka ratifikuar traktatet ndërkombëtare themelore dhe/ose ka mbështetur politikat që e detyrojnë vendin të mbrojë dhe të mbështesë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përfshirë:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW të UN);³⁹
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit);⁴⁰
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BPfA);⁴¹
- Rezolutën 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Gratë, Paqja dhe Siguria” (UNSCR 1325);⁴² dhe
- Konventat Themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)⁴³, dhe Konventën C190 të ILO lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës.⁴⁴

Ligji i BE-së për Barazinë Gjinore dhe GAP III 2021 – 2025, janë të përafuara me dokumentet e lartpërmendura dhe si të tillë përbëjnë një pjesë integrale të procesit të anëtarësimit në BE.

Në **nivel kombëtar**, Kushtetuta e Shqipërisë ndalon diskriminimin me bazë gjinore (Neni 18/2).⁴⁵ Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”⁴⁶ përkufizon termin “integrim gjinor”. Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010

39 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1979), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) Shih: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-elimination-all-forms-discrimination-against-women>

40 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (2011). Shih: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home>

41 Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (1995). Shih: https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing_Declaration_and_Platform_for_Action.pdf

42 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë (2000). Shih: <https://www.unwomen.org/en/docs/2000/10/un-security-council-resolution-1325>

43 Konventat dhe Rekomandimet e ILO-s (në internet). Shih: <https://www.ilo.org/global/standards/introduction-to-international-labour-standards/conventions-and-recommendations/lang--en/index.htm>

44 ILO (2019). Konventa Nr. 190 mbi Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës. Shih: https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C190; dhe gjithashtu: <https://www.ilo.org/global/topics/violence-harassment/lang--en/index.htm>

45 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Shih: <https://www.osce.org/albania/41888>

46 Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar, i botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 125, datë 01.08.2008. Shih: <http://www.osce.org/albania/36682>

“Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar në vitin 2020⁴⁷, detyron të gjitha autoritetet publike të promovojnë barazinë dhe të parandalojnë diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (Neni 7, Mbrojtja nga diskriminimi). Për më tepër, ligji trajton diskriminimin strukturor dhe diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination), si dhe eliminimin e privilegjeve.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030 e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 30.06.2021, në qëllimin strategjik IV përcakton “Aplikimin e integritimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri”.⁴⁸ Ajo parashikon monitorimin e strategjive të reja të cilat duhet të integrojnë këndvështrimin gjinor, si dhe caktimin e buxheteve përkatëse në nivel qendror dhe vendor. Në këtë kuadër, SKBGJ-ja përcakton kuadrin strategjik për integrimin gjinor në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit e tjerë përkatës

Sikurse evidentohet në dokumente si raportet dhe dosjet gjinore për Shqipërinë, në vend vazhdojnë të ekzistojnë mangësi të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve të pabarazisë gjinore dhe në zbatimin e integritimit gjinor.⁴⁹ Këtu përfshihen fusha të politikave në të cilat statusi i pabarabartë i grave është i mirë dokumentuar dhe i vërtetuar qartë nga të dhënat administrative. Ndër arsytet bazë për këtë janë:

- (i) konceptualizimi stereotipik dhe i gabuar i “qytetarit të zakonshëm”, i cili është burrë;

47 I ndryshuar me ligjin nr. 124/2020. Shih: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Law-on-Protection-from-Discrimination-Albania.-2020.pdf>

48 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 112, Datë. 15/07/2021. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112> Varianti anglisht i disponueshëm në: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

49 Komisioni Evropian. Raportet e BE-së për Shqipërinë më 2017, 2018, 2019, dhe 2020; UNDP dhe UN Women (2016). *Gender Brief Albania*. (Dosja Gjinore Shqipëri). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>; UN Women (2020). *Albania Country Gender Equality Brief*. (Dosja e Barazisë Gjinore e Shqipërisë). Shih: [https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020#:~:text=The%20purpose%20of%20UN%20Women's,Sustainable%20Development%20Goals%20\(SDGs\)](https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020#:~:text=The%20purpose%20of%20UN%20Women's,Sustainable%20Development%20Goals%20(SDGs))

- (ii) kapacitete dhe aftësi të kufizuara për integrimin gjinor në administratë;
- (iii) mungesa e detyrimit për të kryer analiza gjinore të rregullta, sipas fushave të politikave; dhe
- (iv) pasqyrimi i dobët i normave dhe standardeve gjinore në proceset, procedurat dhe sistemet e qeverisjes.

Një pengesë e mëtejshme është fakti se individët e përfshirë në hartimin e politikave dhe programeve e kanë të vështirë të përcaktojnë saktësisht se cilat janë çështjet gjinore kryesore në fushat konkrete të punës dhe veprimtarisë së tyre. Si rrjedhojë, shumica dërrmuese e politikave, planeve dhe programeve mbeten pa objektiva konkrete për barazinë gjinore.

Politikat publike hartohen dhe zbatohen me synimin e arritjes së rezultateve të caktuara. Treguesit përvijojnë aspektet rregullatore të arritjes së këtyre rezultateve. Për sa i përket monitorimit të përparimit të bërë në fushën e barazisë gjinore, treguesit e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025 të BE-së mund të shërbejnë si udhërrëfyes të vlefshëm.⁵⁰ Ata ilustrojnë se çfarë ndryshimi (pra, çfarë rezultatesh) është i nevojshëm të arrihet dhe të matet në jetën e grave/vajzave dhe burrave/djemve, në një fushë të caktuar të politikave.

GAP III i BE-së nuk përfshin fushë tematike, objektiv apo tregues të veçantë për masa kundër korrupsionit. Megjithatë, masat kundër korrupsionit janë ndërsektoriale dhe thelbësore për arritjen e të gjithë objektivave tematikë të GAP III të BE-së. Tregues përkatës me ndjeshmëri gjinore janë hartuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe mund të përfshihen gradualisht në politikat kombëtare kundër korrupsionit, si dhe kuadrin përkatës të monitorimit. Në kontekstin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, zbatimi i këtij grupi treguesish do të jepte kontribut për progresin në Kapitujt e BE-së në Grupin Një ("Themeloret"), veçanërisht sa i përket shtetit të së drejtës dhe reformës në administratën publike.

Tabela më poshtë paraqet përafrimin ndërmjet (i) kapitujve përkatës të BE-së për një fushë të caktuar politikash; (ii) dokumenteve përkatëse të politikave kombëtare që përfshijnë konsideratat ndërkombëtare të barazisë gjinore; dhe

⁵⁰ Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *Objectives and Indicators to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*. [Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore III (2021-2025)], fq.27.

(iii) treguesit përkatës të UNODC që do të pasqyrohen në kuadrin kombëtar të monitorimit. Përafrimi plotësohet përmes renditjes së treguesve përkatës të OZHQ-ve, të cilët lidhin integrimin gjinor në procesin e anëtarësimit në BE, me objektivat e barazisë gjinore në shkallë botërore.

TABELA 1

Treguesit gjinorë të lidhur me masat kundër korrupsionit bazuar në udhëzuesin e UNODC⁵¹

Kontributi për një sërë Kapitujsh të BE-së në Grupin Një ("Themeloret", veçanërisht Kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe Kapitulli 24 – Drejtësia, liria dhe siguria)	
Dokumentet strategjike kombëtare përkatëse	<p>Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 i Partneritetit për Qeverisje të Hapur</p> <p>Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Plani i Veprimit 2020-2023</p> <p>Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022</p> <p>Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021-2030</p> <p>Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit 2021-2025</p> <p>Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2020 – 2023</p> <p>Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023</p>

⁵¹ UNODC (2020). *Mainstreaming Gender in Corruption Projects/Programmes*. (Integrimi gjinor në projektet/programet për korrupsionin). Shih: https://www.unodc.org/documents/Gender/20-05712_Corruption_Brief_ebook_cb.pdf

<p>Treguesit gjinorë të lidhur me masat kundër korrupsionit</p>	<p>Numri i planeve të veprimit me masa kundër korrupsionit në nivel kombëtar që marrin në konsideratë rrethana të ndryshme dhe pozicione të pabarabarta të grave dhe burrave</p> <p>Plani i veprimit për masa kundër korrupsionit përfshin të paktën një rezultat të nivelit të lartë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, që do të japë kontribut për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, përkatësisht për OZHQ 5 dhe 16</p> <p>Numri i instrumenteve të standardizuara (p.sh. anketime të opinionit publik, klasifikim të niveleve të korrupsionit, ose niveleve të rryshfetit në sektorin privat) që matin shpeshtinë e përballjes së grave me korrupsion, krahasuar me burrat</p> <p>Numri i instrumenteve të standardizuara të vëna në zbatim që përfshijnë mundësinë e specifikimit të pagesës së rryshfetit me anë të shërbimeve si dhe favoreve seksuale</p> <p>Numri ose përqindja e rasteve studimore ose moduleve të trajnimit që trajtojnë çështjet gjinore dhe stereotipet gjinore</p> <p>Ekspozimi dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave me korrupsionin në shërbimet publike janë analizuar dhe dokumentuar</p> <p>Qëndrimet e grave dhe burrave lidhur me denoncimin e korrupsionit dhe ndaj autoriteteve kundër korrupsionit</p> <p>Besimi dhe perceptimi i grave dhe i burrave për qeverinë</p>
<p>Treguesit e lidhur me OZHQ-të</p>	<p>16.5.1. Proporcioni i personave që kanë pasur të paktën një kontakt me një nëpunëse/nëpunës publik dhe i kanë paguar para (i kanë dhënë rryshfet) asaj/atij nëpunëseje/nëpunësi publik, ose të cilave/cilëve u është kërkuar rryshfet nga ato/ata nëpunëse/nëpunës publikë, gjatë 12 muajve të mëparshëm (metodologjia lejon ndarjen e të dhënave sipas seksit)</p> <p>16.6.2 Proporcioni i popullsisë që është e kënaqur me përvojën e tyre të fundit me shërbimet publike (metodologjia lejon ndarjen e të dhënave sipas seksit)</p>

3.2. Instrumenti i Asistencës së Para - Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas “Rregulloreve të NDICI-t”

Agjenda e Shqipërisë për reforma dhe anëtarësim merr mbështetje të konsiderueshme financiare përmes fondeve të BE-së, si edhe drejtpërdrejt nga shtetet anëtare të BE-së. Bashkimi Evropian, si promovuesi kryesor i barazisë ndërmjet grave dhe burrave në rajon, ka përcaktuar standarde të qarta dhe të përkufizuara shprehimisht në Rregulloret e “Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar” (NDICI) të Komisionit Evropian që u miratuan në qershor 2021.⁵² Këto rregullore vlejné edhe për veprimtaritë në kuadër të IPA III të BE-së që do të financohen dhe zbatohen në Shqipëri dhe formulojnë shprehimisht kriteret e barazisë gjinore:

“[...] Forcimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave në veprimin e jashtëm të Bashkimit [Evropian] dhe shtimi i përpjekjeve për të arritur standardet minimale të performancës që përcaktohen në Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së, duhet të çojnë në një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe transformuese në të gjithë veprimin e jashtëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të BE-së. Të paktën 85 për qind e veprimeve të reja që do të zbatohen në kuadër të këtij instrumenti duhet të kenë barazinë gjinore si objektiv parësor ose të rëndësishëm, sikurse përkufizohet në vlerësuesin e politikave për barazinë gjinore të Komitetit të Asistencës për Zhvillim (DAC) të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD-së). Të paktën pesë për qind e këtyre veprimeve duhet të kenë si objektiv parësor barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin e grave dhe vajzave.”

Nën dritën e Rregulloreve të NDICI-t, të cilat parashikojnë objektivin prej 85 për qind veprime me ndjeshmëri gjinore në të ardhmen, qeveria e Shqipërisë duhet të përcaktojë – në terma konkrete – veprimtaritë, strukturat, mekanizmat dhe kapacitetet për zbatimin e veprimeve me ndjeshmëri gjinore, që është kriter dhe parakusht për suksesin në marrjen e fondeve nga IPA III e BE-së.

3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC

Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i Komitetit të Asistencës së Zhvillimit të Organizatës së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OECD-DAC)⁵³ është

52 Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale; ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

53 OECD DAC Network on Gender Equality (GENDERNET) (2016). *Definition and minimum recommended criteria for the DAC gender equality policy marker*. (Përkufizimi dhe kriteret minimale të rekomanduara për vlerësuesin e politikave për barazinë gjinore të DAC). Shih: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Minimum-recommended-criteria-for-DAC-gender-marker.pdf>

një instrument tepër i rëndësishëm për kryerjen e monitorimit dhe sigurimin e llogaridhënies në kontekstin e Agjendës 2030. Qëllimi i tij është që të identifikojë mangësitë midis angazhimeve ligjore, politike dhe financiare dhe të nxisë përpjekjet për eliminimin e tyre. Për të gjitha programet/veprimet është e detyrueshme kryerja e një analize gjinore dhe ndjekja e qasjes “mos shkakto dëm”.

Programet/veprimet që janë shqyrtuar kundrejt kriterëve të këtij vlerësuesi dhe janë konstatuar se nuk e përmbajnë si synim barazinë gjinore, klasifikohen në kategorinë me 0 pikë. Vlerësimi me 0 pikë duhet të shoqërohet me një shpjegim përshkrues. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por nuk është arsyeja kryesore për kryerjen e programit/veprimit, klasifikohen me 1 pikë. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv kryesor dhe themelor qoftë në hartimin, ashtu edhe në rezultatet e pritshme të tyre, klasifikohen me 2 pikë.

Në Rregulloret e NDICI-t të BE-së – të cilat janë të zbatueshme, për shembull, për Dokumentet e Veprimit të IPA III - përmendet shprehimisht detyrimi për zbatimin e kriterëve minimale të përbashkëta për tri kategoritë e vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së. Ato përcaktojnë objektivin që më së paku 85 për qind e të gjitha veprimeve të ndërmarra duhet të përmbushin kriteret për t'u klasifikuar në kategorinë 1, dhe pesë për qind të përmbushin kriteret e kategorisë 2. Në praktikë, klasifikimi me 1 pikë kërkon që veprimet me përgjigjshmëri gjinore të pasqyrohen në nivelin e analizës së problemeve, objektivave, treguesve dhe arritjeve të synuara.

Përkufizimi i Kategorisë 1:

- Barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por jo arsyeja kryesore për kryerjen e projektit/programit.
- Objektiv i barazisë gjinore duhet të jetë i formuluar shprehimisht në dokumentacionin e projektit/programit dhe nuk mund të jetë i nënkuptuar apo të merret me mend.
- Krahas objektivave të tjera, projekti/programi synon të ketë një ndikim pozitiv në përparimin e mëtejshëm të barazisë gjinore dhe/ose të fuqizimit të grave dhe vajzave, redukton diskriminimin gjinor ose pabarazitë, ose plotëson nevoja gjinore specifike.

TABELA 2

Kërkesat minimale për përmbushjen e kritereve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave të barazisë gjinore të OECD-DAC

Niveli	Kriteri	Përmbushja	Veprimi që duhet ndërmarrë për arritjen e tij
Analiza e Problemit	Është kryer një analizë e statusit, rolit, pozicionit dhe gjendjes së grave/vajzave dhe burrave/djemve në lidhje me një fushë të politikave/ sektor/ nënsektor ku është ndërmarrë projekti/programi/veprimi	<input type="checkbox"/>	Në rastet kur analiza gjinore nuk ekziston, ose është e paplotë apo i ka kaluar koha, duhet të porositet/ të ndërmerret një analizë gjinore specifike për sektorin ose nënsektorin
	Konstatimet e nxjerra nga analiza gjinore:		
	- janë përfshirë në përshkrimin e problemit	<input type="checkbox"/>	
	- mbështeten me shifra (statistika gjinore)	<input type="checkbox"/>	
	- janë marrë për bazë në hartimin e projektit/ programit/veprimit	<input type="checkbox"/>	
	Janë përmendur çështjet kryesore të pabarazisë gjinore në fushën e politikave/ sektorin/ nënsektorin konkret	<input type="checkbox"/>	
	Ndërhyrja i përmbahet qasjes “mos shkakto dëm”	<input type="checkbox"/>	
	Të dhënat statistikore dhe treguesit janë ndarë sipas seksit dhe sipas tipareve të tjera të identitetit, aty ku është e zbatueshme	<input type="checkbox"/>	

Objektivat	Prania e të paktën një objektivi të barazisë gjinore (për shembull, formulimi shprehimisht i synimit për arritjen e objektivave të barazisë gjinore), në përputhje me problemet e pabarazisë gjinore të identifikuar dhe detajuara në analizën përshkuese	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Veprimtaritë	Veprimtaritë e propozuara i përgjigjen posaçërisht situatës së përshkruar të grave/vajzave dhe burrave/djemve, kontribuojnë në arritjen e rezultateve të barazisë gjinore dhe parandalojnë diskriminimin, përfshirë diskriminimin strukturor dhe atë për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination)	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Treguesit	Objektivi ose objektivat e barazisë gjinore mbështeten me të paktën një tregues me ndjeshmëri gjinore, që mundëson: <ul style="list-style-type: none"> - identifikimin e dallimeve gjinore në përfitimet nga masat e parashikuara - monitorimin e ndikimit të masave/veprimtarive mbi gratë/vajzat dhe burrat/djemtë 	□	Harmonizimi me treguesit përkatës të BE-së dhe ata globalë (si për shembull, OZHQ-të, Eurostat/GAP III i BE-së, dhe të tjerë të ngjashëm)

Rezultatet e synuara	Caktohen vlera specifike të matshme për gratë /vajzat dhe burrat/djemtë	□	Reflektimi i qëllimit për eliminimin e dallimeve gjinore/ për arritjen e rezultateve në fushën e barazisë gjinore në vlerat që vendosen për matjen e rezultateve të synuara
-----------------------------	---	---	---

Për t'u klasifikuar në kategorinë 2 të vlerësuesit të politikave të barazisë gjinore të DAC të OECD-së, barazia gjinore duhet të jetë objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe për sa i përket rezultateve të pritshme. Deri tani, numri dhe fushëveprimi i projekteve të financuara në kuadrin e IPA të BE-së që klasifikohen në kategorinë 2 është shumë i ulët.

Përkufizimi i Kategorisë 2:

- Barazia gjinore është objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe në rezultatet e pritshme. Projekti/programi nuk do të ishte ndërmarrë pa këtë objektiv të barazisë gjinore.
- Synimi parësor dhe kryesor në hartimin e projektit/programit është përparimi i mëtejshëm i barazisë gjinore dhe/ose i fuqizimit të grave dhe vajzave, reduktimi i diskriminimit ose pabarazive, ose plotësimi i nevojave gjinore specifike.

4 MJETET KRYESORE PËR INTEGRIMIN GJINOR

Ky seksion përmban një numër mjetesh të standardizuara të BE-së për integrimin gjinor që mund të përdoren në rishikimin e politikave, planifikimet strategjike të ministrive të linjës, në programim, hartimin e buxheteve dhe në procese të tjera qeverisëse të ngjashme. Lista e plotë e mjeteve dhe materialeve burimore të standardizuara të BE-së, ku përfshihen edhe përshkrime të hollësishme të mjeteve për integrimin gjinor, gjendet (në gjuhën angleze) në faqen e internetit të Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), në këtë adresë: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools>

4.1. Analiza gjinore⁵⁴

Analiza gjinore ofron të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për integrimin gjinor në politika, programe dhe projekte. Si procesi që përbën pikënisjen për integrimin gjinor, analiza gjinore identifikon dallimet ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve për sa i përket pozicionit të tyre relativ në shoqëri dhe shpërndarjes së burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit në një kontekst të caktuar. Në këtë mënyrë, kryerja e analizës gjinore bën të mundur zhvillimin e mëpasshëm të ndërhyrjeve që trajtojnë siç duhet pabarazitë gjinore dhe plotësojnë nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi i analizës gjinore është të identifikojë dhe të trajtojë pabarazitë gjinore, përmes:

- pranimin të ekzistencës së dallimeve ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve bazuar në shpërndarjen e pabarabartë të burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit;
- marrjes së masave që nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve të jenë identifikuar dhe trajtuar qartë në të gjitha fazat e ciklit të politikave;
- pranimin se politikat, programet dhe projektet kanë ndikim të ndryshëm tek gratë/vajzat dhe burrat /djemtë;
- kërkimit dhe formulimit të mendimeve të grave/vajzave dhe burrave/djemve dhe përfshirjes së kontributeve të tyre si komponentë të rëndësishëm në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve;
- nxitjes së pjesëmarrjes dhe përfshirjes së grave në jetën e komunitetit, jetën politike dhe ekonomike;

⁵⁴ Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE). *Gender Mainstreaming Methods and Tools* (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-analysis#:~:text=As%20a%20starting%20point%20for,power%20in%20a%20given%20context>

- mbështetjes së ndërhyrjeve që promovojnë barazinë gjinore, të bazuara në të dhëna dhe informacion të besueshëm.

Analiza gjinore përfshin marrjen parasysh të përvojave, roleve dhe përgjegjësi të veçanta të grave, si dhe shkallën e aksesit të tyre në burime dhe në vendimmarrje. Analiza gjinore përfshin gjithashtu njohjen e pabarazive historike dhe shoqërore me të cilat përballen gratë/vajzat dhe synon të shërbejë si informacion bazë për hartimin e politikave, programeve dhe projekteve që trajtojnë – dhe i ndreqin – këto pabarazi.

Kryerja e një analize gjinore të thelluar dhe të gjithanshme bën të mundur që politikëbërëset/ politikëbërësit të kuptojnë pabarazitë gjinore në një kontekst apo sektor të caktuar: ajo bën përshkrimin e stadi aktual të situatave kontekstuale sipas gjinisë, si edhe shqyrton shkaqet dhe pasojat e dallimeve gjinore në grupin e synuar. Shqyrtimi i arsyeve që qëndrojnë në themel të pabarazive dhe diskriminimit gjinor ndihmon në përcaktimin e objektivave dhe masave përkatëse të fokusuara për eliminimin e pabarazive gjinore. Në këtë mënyrë, analiza gjinore kontribuon në përmirësimin e përgjigjshmërisë gjinore të politikave dhe legjislacionit, sepse ofron bazën për të siguruar trajtimin e duhur të nevojave të të gjitha/gjithë qytetarëve/qytetareve: grave, burrave, vajzave dhe djemve.

4.2. Statistikat gjinore mbi korrupsionin në kontekstin shqiptar

Statistikat gjinore përshkruajnë ose matin pabarazitë gjinore. Ato mbështeten në të dhëna për individët, të ndara sipas seksit, pra të dhëna që mbliohen dhe kategorizohen veçmas për gratë/vajzat dhe burrat /djemtë. Këto të dhëna të ndara sipas seksit pasqyrojnë realitetet e jetës së grave/vajzave dhe burrave/djemve, si dhe çështje të politikave që lidhen me gjininë. Ato bëjnë të mundur matjen e dallimeve ndërmjet grave dhe burrave në aspekte të ndryshme shoqërore dhe ekonomike dhe janë të domosdoshme për sigurimin e statistikave gjinore. Për të monitoruar përparimin faktik në fushën e barazisë gjinore, konceptet, përkufizimet dhe metodat e përdorura në prodhimin dhe analizimin e të dhënave duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë rolet, marrëdhëniet dhe pabarazitë gjinore në shoqëri.⁵⁵

⁵⁵ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE). (*Gender Mainstreaming Methods and Tools – Sex-disaggregated data*. [Në internet] (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor – të dhëna të ndara sipas seksit). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/sex-disaggregated-data#:~:text=Data%20collected%20and%20tabulated%20separately,requirements%20in%20obtaining%20gender%20statistics>

Në Shqipëri, statistikat gjinore botohen çdo vit, përmes publikimit të posaçëm të INSTAT-it për këtë qëllim me titull “Gra dhe burra në Shqipëri”.⁵⁶ Objektivi kryesor i këtij botimi është që të vëre në dispozicion të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika gjinore për të mundësuar monitorimin e politikave ndërsektoriale në kuadër të arritjes së objektivave të barazisë gjinore dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në botim përfshihen jo vetëm të dhëna administrative, por edhe të dhëna të bazuara në vrojtimitet sociale që kryen INSTAT-i në nivelin e njësive familjare.

Të dhënat për matjen e korrupsionit kanë për qëllim të hedhin dritë mbi natyrën dhe ndikimin e korrupsionit, dhe këto të dhëna statistikore janë të rëndësishme për hartimin e përgjigjeve të efektshme kundër korrupsionit. Matjet e korrupsionit mund të përdoren për të identifikuar përhapjen dhe prirjet, si dhe për të ilustruar shkallën dhe shtrirjen e llojeve të veçanta të korrupsionit. Ato mund të ndihmojnë politikëbërëset/politikëbërësit, analistet/analistët dhe studiueset/studiuësit të hartojnë mjete për uljen e efektshme të korrupsionit.

Deri tani, në Shqipëri nuk janë prodhuar ende statistika gjinore për korrupsionin. Një burim i dobishëm për mbledhjen e të dhënave për korrupsionin është “Manuali i anketimeve për korrupsionin: Udhëzime metodologjike për matjen e marrjes/dhënies së ryshfetit dhe formave të tjera të korrupsionit përmes anketimeve me kampionë” (2018), hartuar nga UNODC, UNDP dhe UNODC-INEGI Qendra e Ekselencës për Informacione Statistikore mbi Qeveritë, Krimin, Viktimizimin dhe Drejtësinë. Manuali ofron udhëzime specifike për mbledhjen e të dhënave specifike gjinore dhe është i disponueshëm në: https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Crime-statistics/CorruptionManual_2018_web.pdf

4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor

Vlerësimi i ndikimit gjinor është një metodë e standardizuar e BE-së që përdoret rregullisht për vlerësimin *ex ante* të dokumenteve ligjore, planeve të politikave strategjike dhe programeve në proces zbatimi.⁵⁷ Një përdorim më i gjerë i vlerësimit të ndikimit gjinor i ndihmon politikëbërëset/politikëbërësit dhe nëpunëset/nëpunësit publikë që të analizojnë dhe parashikojnë ndikimin që do të ketë tek gratë/vajzat dhe burrat/djemtë çfarëdo vendimi i rëndësishëm që shqyrtohet prej tyre, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e masave ekzistuese dhe do të shërbejë si bazë për marrjen e vendimeve për alokimin e buxheteve.

56 Shih: <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/#tab3>

57 Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE). *Gender Mainstreaming Methods and Tools* (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor): <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/toolkits/gender-impact-assessment/what-gender-impact-assessment>

Përfundimet e nxjerra nga çdo vlerësim i ndikimit gjinor duhet të vihen në dispozicion në kohë, në mënyrë që të bëhet i mundur ndryshimi i akteve ligjore dhe politikave të tjera përkatëse gjatë fazave të hartimit dhe planifikimit.

‘Vlerësimi i ndikimit gjinor mund të kryhet për aktet legjislative, planet e politikave, programet e politikave, buxhetet, veprimet konkrete, projektligjet dhe raportet apo angazhimet për punë kërkimore shkencore. Metodatat e vlerësimit të ndikimit gjinor duhet të zbatohen jo vetëm për politikatat që janë në fazën e hartimit; ato mund të zbatohen edhe në kuadër të politikave tashmë ekzistuese. Ato mund të përdoren si në administratë, ashtu edhe nga aktorë të jashtëm; në të dy rastet ato kërkojnë një sasi të konsiderueshme njohurish lidhur me çështjet gjinore.’⁵⁸

Kohët e fundit, në kuadër të Projektit SANECA të administruar nga GIZ-i, instrumenti i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor *ex ante* të BE-së u përshtat për kontekstin shqiptar, me fokus të veçantë mbi përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të ashtuquajturit “kapitujt e tregut të brendshëm” të BE-së (pra kapitujt 1, 3, 20 dhe 28).⁵⁹ Në Kosovë, Agjencia për Barazi Gjinore – që operon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit – përgatiti në vitin 2019 një Manual të posaçëm për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor me mbështetjen financiare të Suedisë.⁶⁰

4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në masat kundër korrupsionit

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ) është proces kryesor për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në planifikim. Ai “synon të sigurojë që mbledhja dhe alokimi i burimeve publike të kryhet në mënyra të cilat janë efektive dhe kontribuojnë për të çuar përpara barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave”.⁶¹ Është e rëndësishme

58 Këshilli i Evropës (2004). *Gender mainstreaming: Conceptual framework, methodology and presentation of good practices* (Integrimi gjinor: korniza konceptuale, metodologjia dhe prezantimi i praktikave të mira). http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/gender-mainstreaming/EG_S_MS_98_2_rev_en.pdf

59 GIZ (2022). *Gender Mainstreaming in the Internal Market Chapters of the Acquis - Guidelines and Tools* (Integrimi gjinor në kapitujt e tregut të brendshëm të acquis – Udhëzime dhe mjete). Shih: https://pubhtml5.com/qzcc/xxqq/Gender_Mainstreaming_in_the_Internal_Market_Chapters_of_the_Acquis/3

60 Republika e Kosovës Agjencia për Barazinë Gjinore (2019). Manuali i Vlerësimit të Ndikimit Gjinor. Shih: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Gender%20Equality%20mapact%20Assessment%20Manual.pdf>

61 UN Women Asia Pacific. *Gender Responsive Budgeting*. (Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor). Shih: <https://asiapacific.unwomen.org/en/focus-areas/women-poverty-economics/gender-responsive-budgeting>, paragrafi 1.

të theksohet që buxhetimi i përgjigjshëm gjinor nuk do të thotë që të krijohet një buxhet i veçantë për gratë, e as që thjesht të shtohen fondet e shpenzuara në programet për gratë. Disa shembuj se si mund të zbatohet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, krahas integritimit gjinor në masat kundër korrupsionit janë⁶²:

- ☑ Përfshirja e përgjigjshmërisë gjinore në qeverisje, në ofrimin e shërbimeve publike përmes buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, mekanizmave të llogaridhënies publike që përfshijnë gratë dhe organizatat e shoqërisë civile të grave, si dhe strategjive për ofrimin e shërbimeve publike për gratë dhe vajzat.
- ☑ Përfshirja në terma afatgjatë e ndërtimit të kapaciteteve të grave në aftësi teknike/teknologjike, leadership dhe negociim, si dhe njohuri e intuitë financiare.
- ☑ Alokimi i burimeve për rritjen e ndërgjegjësimit gjinor dhe ndërtimi i kapaciteteve për integrimin gjinor në të gjitha nivelet, si dhe në mënyra të përshtatura me nevojat e grupeve të ndryshme të synuara, si politikëbërëset/politikëbërësit, stafet e programeve, përfitueset/përfituesit gra dhe burra, stafet e institucioneve vendore përkatëse, institucionet që ofrojnë shërbime, si dhe gratë/vajzat/burrat/djemetë nga komunitetet e cenueshme.

4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor

Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor (PPPGJ) është prokurim që nxit barazinë gjinore përmes blerjes së mallrave, shërbimeve apo punimeve. Kjo do të thotë që blerëset/blerësit dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve (i) të analizojnë ndikimin që kanë të gjitha veprimtaritë e kontraktuara mbi nevojat, interesat dhe shqetësimet e grave dhe burrave; dhe (ii) të hartojnë dhe t'i realizojnë kontratat në mënyrë të tillë që redukton pabarazitë. PPPGJ-ja nuk nënkupton domosdoshmërisht shpenzime më të mëdha, por kërkon njohuri dhe kapacitete.⁶³

Prokurimi publik dhe akordimi i kontratave kompanive private që punësojnë fuqi punëtore nga jashtë kompanisë mund të sjellë ndikim pozitiv në rritjen e punësimit në nivel vendor në përgjithësi, dhe në mundësitë e punësimit të grave në veçanti. Në thirrjet për propozime në programet e financimit ose në termat e referencës të procedurave të prokurimit publik – ndër të cilat edhe ato për kontraktorët që do të angazhohen për shërbimet në mbështetje të politikave – mund të përfshihen klauzola që përmendin produktet sociale që synohet të

62 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption*. (Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

63 Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) (2016). *Gender Mainstreaming Methods and Tools* (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor) Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

arrihen (për shembull, përçindja e punëtoreve/punëtorëve vendas të kontraktuar sipas kategorisë; përçindja e grave që do të punësohen; detyrimi për të zvogëluar pabarazitë gjinore; respektimi i parimeve të barazisë gjinore, dhe të tjera të ngjashme). Kjo do të sigurojë që projektet dhe shërbimet që marrin fonde të kenë të përfshirë kapacitetet gjinore, t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të grave/vajzave/burrave/djemve, si dhe të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore.⁶⁴

Komisioni Evropian shprehimisht thekson në strategjinë e vet për barazinë gjinore 2020-2025 se 'udhëzimet e Komisionit për prokurime publike me përgjegjësi sociale do të luftojnë diskriminimin dhe promovojnë barazinë gjinore në tenderët publikë'.⁶⁵ Si një nga produktet e para të strategjisë, në prill 2023, Komisioni miratoi rregulla të reja dhe masa shtrënguese për transparencën e pagesave, në kuadër të Direktivës për Transparencën e Pagave, e cila në mënyrë specifike trajton pagesën e barabartë dhe hendekun gjinor në paga në kontekstin e prokurimeve publike (në nenin 21).⁶⁶ Për udhëzuesin e detajuar të BE për PPPGJ shihni: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>.⁶⁷

Shembuj të tjerë të PPPGJ-së përfshijnë Zvicrën, ku çdo kompani që punon me qeverinë është e detyruar të paguajë në mënyrë të barabartë burrat dhe gratë anëtarë të stafit. Në Spanjë, Ligji për Prokurimet Publike përfshin një sërë dispozitash për barazinë gjinore që lidhen me faza të ndryshme të procedurës së prokurimit, nga përzgjedhja e kontraktorit e deri tek zbatimi i kontratave publike. Asnjë person që është i dënuar për shkelje të të drejtave të punëtoreve/punëtorëve, përfshirë sjellje që shkelin të drejtën dhe mundësitë e grave, si diskriminimi apo ngacmimi, nuk mund të nënshkruajë kontrata me institucione të sektorit publik. Kompanitë me më shumë se 250 punonjëse/punonjës që nuk zbatojnë plane të barazisë gjinore janë gjithashtu të ndaluara të marrin pjesë në procedurat e prokurimeve publike.⁶⁸ UN Women promovon

64 Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE). (2016). 'Gender and Digital Agenda' (Gjinia dhe agjenda digjitale). Shih: <https://eige.europa.eu/publications/gender-and-digital-agenda>

65 Komunikata e Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve - *A Union of equality: Gender equality strategy 2020-2025* (Një Bashkim me barazi: Strategjia e barazisë gjinore 2020-2025), COM(2020) 152, 5.3.2020. Shih: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX %3A52020DC0152](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152)

66 DIREKTIVA E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT për të forcuar zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave nëpërmjet transparencës dhe mekanizmit të zbatimit të pagave 2021/0050(COD), PE-CONS 81/22, 11.4.2023. Shih: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-81-2022-INIT/en/pdf>.

67 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE). *Gender Mainstreaming Methods and Tools* [Në internet]. (Metodat dhe mjetet për integrimin gjinor). Gjetet në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

68 UNODC (2020). *The Time Is Now: Addressing the Gender Dimensions of Corruption* (Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit). Shih: https://www.unodc.org/documents/corruption/Publications/2020/THE_TIME_IS_NOW_2020_12_08.pdf

metoda të tjera që sjellin përfitime në ekonomi, si (i) mbështetja e rregullave të prokurimit që i japin përparësi ofertave të bizneseve në pronësi të grave; dhe (ii) nxitjen e kompanive përtej grupimeve të zakonshme të biznesit, duke zgjeruar kështu gamën e mundësive të punësimit dhe krijuar tregje të reja.⁶⁹

4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor

Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor përdoret për të treguar nëse në një program të caktuar trajtohen përparësitë dhe nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi është të vlerësohet nëse programi ka ndikimin e parashikuar (ose edhe ndonjë ndikim të paparashikuar) në marrëdhëniet gjinore dhe të përcaktohen aspektet gjinore që duhen integruar në sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit. Një monitorim dhe vlerësim i ndjeshëm gjinor që është efektiv duhet të përfshijë si të dhëna cilësore ashtu edhe sasiore që matin ndikimin mbi marrëdhëniet midis gjinive. Pa të dhëna të mjaftueshme është shumë e vështirë të bëhet një analizë e plotë e ndikimit të programeve mbi barazinë gjinore. Kjo do të thotë që të gjitha të dhënat duhet të mblidhen, paraqiten dhe analizohen më së paku të ndara sipas seksit.⁷⁰ Gjithashtu, rezultatet dhe informacionet e marra nga monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor shërbejnë si bazë për ciklet e politikave: ato identifikojnë aspektet për të cilat do të duhet të përfshihen objektiva dhe tregues të barazisë gjinore të formuluar shprehimisht në fazën e planifikimit.

Për shembull, raportet e monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit në Shqipëri (2015-2023) përfshijnë informacione të kategorizuara sipas gjinisë mbi numrin e nëpunësive/nëpunësve pjesëmarrëse/pjesëmarrës në trajnime dhe veprimtari të tjera për zhvillimin e kapaciteteve, çka është një fillim i mirë për monitorimin e ndjeshëm gjinor.⁷¹ Megjithatë, ushtrimi i monitorimit do të përfitonte në mënyrë të konsiderueshme nëse aspekte të tjera gjinore do të përfshiheshin në këtë proces, përfshirë ndikimin e veprimtarive mbi marrëdhëniet gjinore. Sidoqoftë, monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor i politikave kundër korrupsionit kërkojnë integrim gjinor të vazhdueshëm në këto politika, përfshirë përcaktimin e treguesve të qartë gjinorë. (Shihni gjithashtu pjesën 3.1 më lart).

69 UN Women (2017). *The Power of Procurement: how to source from women-owned business* (Fuqia e Prokurimeve: si të furnizohet nga biznese në pronësi të grave). Shih: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2017/3/the-power-of-procurement>

70 Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) *Thesaurus* (Fjalor tematik i termave). Shih: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1217?lang=en>

71 Shih: <https://www.drejtësia.gov.al/viti2021/>

5 REKOMANDIME TË RËNDËSISHME NË MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

Ndërhyrjet për integrimin gjinor përfshijnë ngritjen e kapaciteteve për kryerjen e analizave gjinore, si dhe angazhimin aktiv të specialisteve/specialistëve të integritetit gjinor përgjatë të gjithë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive dhe politikave. Për më tepër, politikat ekzistuese në zbatim e sipër duhet të shqyrtohen lidhur me ndjeshmërinë e tyre gjinore (pra të vlerësohet si i trajtojnë ato pabarazitë gjinore në sektor/fushën e politikës). Nëse është e nevojshme, këto politika duhet të rishikohen, me qëllim integrimin gjinor në strategjitë sektoriale dhe në strukturat, sistemet dhe proceset e të gjitha institucioneve të përfshira.

Si pasojë, duke qenë se efektet e korrupsionit nuk janë neutrale nga këndvështrimi gjinor, është e nevojshme të vendoset dialog ndërmjet atyre që luftojnë kundër korrupsionit dhe atyre që punojnë drejt barazisë dhe trajtimit të barabartë gjinor, me qëllim mundësimin e: (i) botëkuptimit më të mirë të përbashkët për lidhjet midis pabarazisë gjinore dhe korrupsionit; (ii) përparësive të politikave publike që janë më pranë të dyja çështjeve; dhe (iii) veprimeve të veçanta, të koordinuara dhe të artikuluar që trajtojnë çështjet e mbivendosura dhe që konvergojnë.⁷²

⁷² UROsociAL, Transparency International, dhe UN WOMEN (2018). "Anti-corruption and gender dialogue: Workshop proceedings". ("Masat kundër korrupsionit dhe dialogu gjinor: Punimet e seminarit". Shih: <https://lac.unwomen.org/en/noticias-y-eventos/articulos/2018/5/dialogo-anticorrupcion-y-genero>)

TABELA 3

Veprimet prioritare për integrimin e qëllimeve të barazisë gjinore në përpjekjet kundër korrupsionit⁷³

Çështja kryesore gjinore	Veprimet prioritare të politikave
<p>Korrupsioni dhe përfaqësimi i ulët i grave në qeveri, biznes, etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li data-bbox="601 689 1273 910">☑ Alokimi i burimeve për trajnimin dhe mbështetjen e grave si drejtuese: shpesh gratë janë të reja në nivelet vendimmarrëse; nevojitet zhvillim kapacitetesh dhe mbështetje institucionale që pjesëmarrja e grave të mos jetë vetëm çështje shifrash, por edhe efektshmërie. <li data-bbox="601 944 1273 1208">☑ Hartimi dhe/ose përforcimi i politikave për rritjen e përfaqësimit të grave në institucionet e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale (p.sh. rishikimi i politikave dhe praktikave për rekrutimin dhe personelin, fushatat e ndërgjegjësimit që trajtojnë normat stereotipike gjinore). <li data-bbox="601 1242 1273 1378">☑ Zbatimi i masave të veçanta për matjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave nga grupet e pafavorizuara në jetën publike dhe politike. <li data-bbox="601 1412 1273 1561">☑ Marrja e masave ligjore dhe politikave për trajtimin e dhunës ose kërcënimit të grave që marrin pjesë në jetën politike dhe publike (p.sh. nëpunëse të zgjedhura, administratë, biznes).

⁷³ Rekomandimet bazohen në dhe janë përshtatur nga rekomandimet e paraqitura në burime të ndryshme, përfshirë: UNODC (2020). "Ka ardhur momenti: Trajtimi i dimensioneve gjinore të korrupsionit; Transparency International (2014). Pabarazia Gjinore dhe Korrupsioni: Cilat janë Lidhjet?; OSBE (2021). Ndikimi gjinor i korrupsionit në kujdesin shëndetësor shqiptar dhe në arsimin e lartë, Hulumtim paraprak dhe vlerësim nevojash; OSBE (2021). Gjinia dhe korrupsioni: Çfarë do të bëjmë tani? Një punim për diskutim; Banka Interamerikane për Zhvillim (2018). Integrimi Gjinor në Fondin e Transparencës. Shihni: <https://publications.iadb.org/en/gender-mainstreaming-transparency-fund>

Korrupsioni ndikon mbi gratë, veçanërisht lidhur me aksesin e tyre në drejtësi

- Në reformat që luftojnë korrupsionin në sektorët e drejtësisë, të sigurohet efektivitet përmes trajtimit të përshtatshëm të prioriteteve të grave viktime të dhunës me bazë gjinore, trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe aksesit të tyre në drejtësi.
- Sigurohet trajnim për të drejtat e njeriut, masat kundër korrupsionit, si dhe trajnim specifik për çështjet gjinore si pjesë e zhvillimit të brendshëm të kapaciteteve të gjyqtareve/gjyqtarëve, prokuroreve/prokurorëve, oficerëve/oficerëve të drejtësisë penale dhe pjesëtarëve/pjesëtarëve të tjerë të agjencive të zbatimit të ligjit.
- Krijimi dhe përmirësimi i mekanizmave të bashkëpunimit institucional ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe autoriteteve kundër korrupsionit për të trajtuar dimensionin gjinor në luftën kundër korrupsionit në sektorin e drejtësisë.
- Mbështetja e promotoreve/promotorëve të barazisë gjinore dhe kundër korrupsionit në institucionet e zbatimit të ligjit si dhe informimi i grave në këta sektorë mbi mënyrën si mund të sjellin ndryshim institucional dhe si të mbrojnë veten kundër rrjeteve të korrupsionit.
- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për dimensionin gjinor të korrupsionit duke synuar kryesisht burrat dhe organizimi i trajnimeve për menaxhimin e diversitetit me personelin burra.
- Dhënia përparësi e alokimeve buxhetore për reduktimin e korrupsionit gjatë ofrimit të shërbimeve publike nga të cilat gratë varen dhe përdorin më shumë se burrat, si mënyrë konkrete për integrimin e masave të barazisë gjinore në përpjekjet kundër korrupsionit.

Gratë përballen me ekspozim më të madh ndaj korrupsionit në shërbimet shoqërore

- Ndërgjegjësimi për çështjet e korrupsionit të hasura nga gratë gjatë qasjes në shërbime (si në sektorin publik, ashtu edhe privat).
- Vlerësimi i ndikimit konkret të korrupsionit mbi popullsinë, përfshirë mbi gratë dhe burrat, dhe mbi grupe të ndryshme të shoqërisë, çka më pas së bashku me reformat e rëndësishme institucionale dhe të politikave mbështet qeverinë në përmirësimin e perceptimit për korrupsionin.
- Integrimi gjinor në procesin e ofrimit të shërbimeve publike, përmes: buxhetimit të përgjigjshëm gjinor; mekanizmave të llogaridhënies publike që përfshijnë gratë dhe organizatat e shoqërisë civile të grave; dhe strategjive për ofrimin e shërbimeve publike për gratë dhe vajzat.
- Përpjekjet kundër korrupsionit bëhen të përgjigjshme nga pikëpamja gjinore duke kryer auditime sociale të aksesit të grave në shërbime dhe duke përcaktuar procedura të përkushtuara raportimi për gratë dhe vajzat që kërkojnë të ngrenë ankesa.

<p>Format e korrupsionit me veçanti gjinore ndikojnë gratë në mënyrë jo proporcionale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <input checked="" type="checkbox"/> T'u jepen rëndësi formave të korrupsionit që ndikojnë më shumë gratë, si zhatja seksuale dhe trafikimi i qenieve njerëzore, duke i vendosur këto çështje në fokus të veçantë të përpjekjeve kundër korrupsionit. <input checked="" type="checkbox"/> Politikat përkatëse kundër korrupsionit duhet të kenë qasje me në qendër viktimën, me qëllim që personave t'u bëhet e mundur të denoncojnë korrupsionin. <input checked="" type="checkbox"/> Ngritja e sistemeve të ankesave me përgjigjshmëri gjinore duke siguruar një mekanizëm të aksesueshëm dhe transparent me një ndalesë për marrjen, regjistrimin dhe ndjekjen e denoncimit për korrupsion, së bashku me gjurmimin e kategorizuar sipas seksit, të llojit të ankesës dhe llojit të zgjidhjes.
<p>Dallimet gjinore në perceptime, qëndrime dhe sjellje që lidhen me korrupsionin</p>	<ul style="list-style-type: none"> <input checked="" type="checkbox"/> Gratë të përfshihen në hartimin e strategjive kundër korrupsionit me përgjigjshmëri gjinore; grupet e grave janë aleate të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit dhe shumë organizata bazë kanë krijuar qasje të suksesshme për trajtimin e korrupsionit në kontekste të ndryshme. <input checked="" type="checkbox"/> Përfshirja në veprimtaritë kundër korrupsionit të qytetareve/qytetarëve, aktivisteve/aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe grave palë interesi, në bazë të një plani të përcaktuar veprimi dhe angazhimi në ndjekje të përkushtuar me qëllim trajtimin e efektshëm të korrupsionit. <input checked="" type="checkbox"/> Të garantohet raportimi me ndjeshmëri gjinore në kuadër të mekanizmave sinjalizues dhe sistemit të ankesave për raportimin e korrupsionit; këto mekanizma duhet të jenë transparent, të pavarur, llogaridhënës, të aksesueshëm, të sigurt dhe të thjeshtë në përdorim.

Mungesat lidhur me të dhënat gjinore mbi korrupsionin parandalojnë trajtimin e sfidave të veçanta gjinore

- ☑ Të përforcohet koordinimi ndërmjet institucioneve që prodhojnë të dhëna dhe INSTAT-it me synim përlllogaritjen e treguesve gjinorë të standardeve ndërkombëtare për korrupsionin në Shqipëri.
- ☑ Përfshirje në të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen e treguesve gjinorë dhe të korrupsionit në përputhje me metodologjitë e OZHQ-ve dhe UNODC-së.
- ☑ Gjatë mbledhjes së të dhënave të përfshihet dimensionin gjinor i korrupsionit.
- ☑ Të mbështetet përcaktimi i treguesve 16.5.1 dhe 16.6.2 të OZHQ-ve dhe të garantohet kategorizimi gjinor sipas metodologjisë.
- ☑ Të hartohen të dhëna lidhur me praninë e llojeve të ndryshme të korrupsionit dhe dinamikave përkatëse gjinore për të informuar reagimin dhe zhvillimet e politikave kombëtare.
- ☑ Të merren masa konkrete për lidhjen e reformave në politika me mbledhjen e të dhënave të reja me ndjeshmëri gjinore dhe të bëhen kërkime për njohuri lidhur me shtysat, shkaqet dhe ndikimet e korrupsionit mbi gratë dhe burrat.



DREJTËSIA

MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

SHËNDETËSIA

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

ADMINISTRATA PUBLIKE

VETËQEVERISJA VENDORE DHE ZHVILLIMI VENDOR

RINIA